

USAID dhe Yunnus Social Business Balkans (së bashku me Impact Hub Vienna) në kontekstin e programit mbi “Rritjen e biznesit social ne Shqipëri” do të organizojë për herë të dytë konkursin kombëtar “Social Impact Award”, për sipërmarrësit e rinj të moshave 15-30 vjeç.

Më datën 28 Maj 2018 u mbajt në Universitetin “Eqrem Cabej” pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, Ora 11:00 një seancë trajnimit dhe këshillimi mbi start-upet si gjenerimi i ideve të sipërmarrjes sociale, analiza e tregut, zhvillimi i vlerës së propozuar, modelimi i biznesit, planifikimi financiar i biznesit.

Ky program edukues ka si qëllim të trajnojë sipërmarrësit e rinj duke ju ofruar mundësinë të fitojnë aftësi praktike që nuk mësohen në shkollë mbi sipërmarrjen.





